

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË “FOLEJA ” SHPK

Sot, më datë 09.08.2024, në praninë e Ortakut të Vetëm Themelues të shoqërisë “FOLEJA” SHPK, si më poshtë:

Ortak i Vetëm Themelues i shoqërisë “FOLEJA” SHPK, është Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “KES Group” LLC (“Shoqëria”), person juridik, i regjistruar në ARBK (Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës) Republika e Kosovës, me adresë në: Rruga Ahmet Krasniqi, p.n., me Aktivitet kryesor të biznesit: “Tregtia me pakicë me porosi nga shtëpia nëpërmjet postës ose internetit.”, përfaqësuar nga Drejtori i Shoqërisë z. **Agon Ferati**, i biri Muja Ferati i datëlindjes 17.10.1988 shtetas i Republikës së Kosovës, lindur në Prishtinë dhe banues në Prishtinë, identifikuar me nr personal 1500407987, dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Bazuar në nenet 6 e vijues të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), nënshkruhet ky Akt Themelimi, në të cilin Ortaku i Vetëm Themelues shpreh vullnetin të themelojnë shoqërinë tregtare “FOLEJA” SHPK, me kushtet si vijon:

NENI 1
Emri i shoqërisë

- 1.1 Emri i shoqërisë do të jetë “FOLEJA” SHPK.
- 1.2 Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë mban përgjegjësi të kufizuar deri në deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara të kapitalit bazë të shoqërisë.

NENI 2
Forma e shoqërisë

- 2.1 Forma e shoqërisë “FOLEJA” SHPK (në vazhdim referuar si “Shoqëria”) do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.
- 2.2 Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 3
Selia e shoqërisë



- 3.1 Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Pranë Universitetit Western Balkans, Autostrada Tirane - Durres Km 7, Tirana 1001.
- 3.2 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 4 **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

- 4.1 Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 4.2 Ortaku i Vetëm/ Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e tij një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 5 **Objekti i veprimtarisë**

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në:

- Tregtia me pakicë me porosi nga shtëpia nëpërmjet postës ose internetit
- Tregtia me shumicë e kompjuterëve, e pajisjeve periferike të kompjuterëve dhe softuerëve
- Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël
- Tregtia e automjeteve të tjera
- Tregtia me shumicë e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve
- Tregtia me pakicë e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve
- Tregtia, mirëmbajtja dhe riparimi i motoçikletave dhe pjesëve e aksesorëve të tyre
- Tregtia me shumicë e drithërave, duhanit të papërpunuar, farërave dhe ushqimit të kafshëve
- Tregtia me shumicë e luleve dhe bimëve
- Tregtia me shumicë e frutave dhe perimeve
- Tregtia me shumicë e mishit dhe produkteve të tij
- Tregtia me shumicë e produkteve të qumështit, vezëve, vajrave dhe yndyrnave të gatimit
- Tregtia me shumicë e pijeve
- Tregtia me shumicë e produkteve të duhanit
- Tregtia me shumicë e sheqerit, e çokollatës dhe e ëmbëlsirave
- Tregtia me shumicë e kafes, çajit, kakaos dhe erëzave



Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë ushqimorë, përfshirë peshkun, krustacet dhe molusqet (frutat e detit)

Tregtia me shumicë, jo e specializuar, e artikujve ushqimorë, pijeve dhe duhanit

Tregtia me shumicë e tekstileve

Tregtia me shumicë e veshjeve dhe këpucëve

Tregtia me shumicë e pajisjeve elektroshtëpiake

Tregtia me shumicë e porcelanit dhe artikujve të xhamit, si dhe e materialeve pastruese

Tregtia me shumicë e artikujve të parfumerisë dhe kozmetikës

Tregtia me shumicë e artikujve farmaceutikë

Tregtia me shumicë e mobilie, qilimave dhe pajisjeve të ndriçimit

Tregtia me shumicë e orëve dhe e artikujve të argjentarisë

Tregtia me shumicë e artikujve të tjerë shtëpiake

Tregtia me shumicë e pajisjeve elektronike dhe të telekomunikimit, si dhe pjesëve të tyre

Tregtia me shumicë e makinerive bujqësore, pajisjeve dhe pjesëve furnizuese

Tregtia me shumicë e veglave të makinerive

Tregtia me shumicë e makinerive të minierave, të ndërtimit, si dhe për punime inxhinierike

Tregtia me shumicë e makinerive të industrisë tekstile dhe të makinave të qepjes dhe thurjes

Tregtia me shumicë e mobilie të zyrave

Tregtia me shumicë e makinerive dhe pajisjeve të tjera të zyrave

Tregtia me shumicë e makinerive dhe pajisjeve

Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to

Tregtia me shumicë e drurit, materialeve të ndërtimit dhe pajisjeve hidrosanitare

Tregtia me shumicë e pjesëve elektronike, pajisjeve hidraulike dhe të ngrohjes, si dhe pjesëve të furnizimit

Tregtia me shumicë e produkteve kimike

Tregtia me shumicë e produkteve të tjera të ndërmjetme

Tregtia me shumicë jo e specializuar

Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani

Tregti tjetër me pakicë në dyqane jo të specializuara

Tregtia me pakicë e bukës, ëmbëlsirave, produkteve prej mielli dhe produkteve prej sheqeri, në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e pijeve në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e produkteve të duhanit në dyqane të specializuar

Tregtia me pakicë e produkteve të tjera ushqimore në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e karburantit për automjete në dyqane të specializuar

Tregtia me pakicë e kompjuterëve, njësive periferike dhe softuerëve, në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikimit në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e pajisjeve audio dhe video në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e artikujve elektronikë, ngjyrave dhe xhamit, në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e pajisjeve elektroshtëpiake në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e mobilieve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve të tjerë shtëpiakë, në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e librave në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e gazetave dhe materialit të shkrimit, në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e incizimeve muzikore dhe videove, në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e lojërave dhe lodrave, në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure, në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e artikujve farmaceutikë në dyqane të specializuara (Barnatore)

Tregtia me pakicë e artikujve ortopedikë dhe mjeksorë, në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e artikujve kozmetikë dhe të tualetit, në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farërave, plehrave artificialë, kafshëve përkdhelëse dhe ushqimi i tyre, në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e orëve dhe argjentarisë në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e mallrave të tjera të reja, në dyqane të specializuara

Tregtia me pakicë e mallrave të përdorura në dyqane

Tregtia tjetër me pakicë, jo në dyqane, tezga ose tregje

Magazinimi dhe ruajtja

Aktivitetet e tjera postare dhe të ndërlidhjes

Aktivitetet e tjera shërbyese të ushqimit

Publikimi i lojërave kompjuterike

Publikimi i softuerëve të tjerë

Aktivitetet e prodhimit të filmave, videove dhe programeve televizive

Aktivitetet e post-produksionit të filmave, videove dhe programeve televizive

Aktivitetet e shpërndarjes së filmave, videove dhe programeve televizive

Aktivitetet e projektimit të filmit

Incizimi i zërit dhe aktivitetet e publikimit të muzikës

Transmetimi i programeve radiofonike

Teknologjia tjetër informative dhe aktivitetet shërbyese kompjuterike

Përpunimi i të dhënave, hostimi i informacionit dhe aktivitetet e lidhura me to



Aktivitetet e kompanive "holding"
Aktivitetet e këshillimit për biznes dhe këshillat e tjera për manaxhim
Testimi teknik dhe analizat
Kërkime dhe zhvillime të tjera eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinieri
Kërkimi dhe zhvillimi eksperimental në shkencat shoqërore dhe humane
Agjenci për publicitetet dhe reklamë dhe të gjitha aktivitetet e përfshira në të
Hulumtimi i tregut dhe matja e opinionit publik (sondazhet)
Aktivitetet e fotografimit
Aktivitetet e parqeve të argëtimit dhe atyre me orientim të caktuar
Aktivitetet e tjera të argëtimit dhe rekreacionit
Aktivitetet e tjera
Aktivitetet e tjera shërbyese financiare, përveç fondit të sigurimit dhe atij pensional
Aktivitetet e tjera ndihmëse për shërbimet financiare, përveç financimit të sigurimit dhe fondeve pensionale
Aktivitetet e kontabilitetit, libërmbajtjes dhe auditimit; këshillime tatimore
Aktivitetet e udhëheqjes së ndërmarrjeve
Marrëdhëniet me publikun dhe aktivitetet e komunikimit
Aktivitetet e specializuara të dizajnit
Aktivitetet e tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve
Riparimi i artikujve personal dhe shtëpiakë

NENI 6 Kapitali i Shoqërisë

- 6.1 Kapitali bazë i shoqërisë është në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale prej 100,000 (njëqind mijë) lekë.
- 6.2 Ortaku themelues zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 100% në kapitalin bazë të shoqërisë.
- 6.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe paguar në tërësinë e tij nga ortaku i vetëm themelues.

NENI 7 Organet Drejtuese

- 7.1 Bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/Mbledhja e Ortakut të Vetëm — organi më i lartë vendimmarrës;



2. Administratori — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

7.2 Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8 **Administrimi**

- 8.1 Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj, i cili mund të zgjidhet për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
- 8.2 Administratori i Shoqërisë “FOLEJA” SHPK do të jetë Z. Endrit Hoxha, i biri i Rasim, dhe Aferdita, me shtetësi shqiptare, lindur në Lezhë, Shqipëri me datë 08-04-1985, i identifikuar me ID me numër personal: I50408025F, me adresë: 1045 Selitë Lagja 13, Rr. Bill Clinton 20 1 30, Tiranë, madhor, dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i cili emërohet për mandat me afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi.
- 8.3 Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij.

NENI 9 **Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ky akt themelimi, si dhe parashikimet e Statutit të saj.

NENI 10 **Regjistrimi**

Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 11 **Dispozitat përfundimtare**

Ky Akt Themelimi përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqip, dhe nënshkruhet nga ortaku i vetëm themelues.



ORTAKU I VETËM THEMELUES I SHOQËRISË “FOLEJA” SHPK,
“KES Group” LLC
Përfaqesuar nga

AGON FERATI


Z. AGON FERATI
Drejtore i “KES Group” LLC

